



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete transporti dhe mjete nivelimi, për nevojat e Bashkisë Divjakë”, i ndarë në lote si mëposhtë:

Loti I-rë: “Blerje mjete transporti (dy kamiona, tre kamionçina dhe një kamion me vinç)”

Loti III-të: “Blerje mjete nivelimi (një rrul dhe një grejder)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34136200-1 Kamionçina, (CPV): 34134200-7 Kamionë vetëshkarkues, (CPV): 43312400-7 Rule rrugësh, (CPV): 42990000-2 Makineri të ndryshme për qëllime të veçanta

VLERA E FONDIT LIMIT: 51,406,666 (pesëdhjetë e një milion e katërqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh, nga e cila: 45,290,000 (dyzetë e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 6,116,666 (gjashtë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 518,997 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 24.09.2024 është 99.05.

I ndarë në lote si mëposhtë:

Loti I-rë: “Blerje mjete transporti (dy kamiona, tre kamionçina dhe një kamion me vinç)” me fond limit: 42,373,333 (dyzetë e dy milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh, nga e cila: 41,190,000 (dyzetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 1,183,333 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë për Loti I-rë: “Blerje mjete transporti (dy kamiona, tre kamionçina dhe një kamion me vinç)” është: 427,797 (katërqind e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) euro pa

TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 24.09.2024 është 99.05.

Loti III-të: “Blerje mjete nivelimi (një rrul dhe një grejder)” me fond limit: 9,033,333 (nëntë milion e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh, nga e cila: 4,100,000 (katër milion e njëqind mijë) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 4,933,333 (katër milion e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë për Loti III-të: “Blerje mjete nivelimi (një rrul dhe një grejder)” është: 91,200 (nëntëdhjetë e një mijë e dyqind) euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 24.09.2024 është 99.05.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Divjakë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI I-RË: “BLERJE MJETE TRANSPORTI (DY KAMIONA, TRE KAMIONCINA DHE NJË KAMION ME VINC)”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 dhe nenin 42 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/a citohet: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/a, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit ose lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm, që garantojnë Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”,* si edhe të pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”.* Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë garancie për mjetet e ofruara, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi gjatë periudhës së garancisë, si dhe periudha e garancisë teknike për secilin mjet, do të jetë minimumi 1 vit nga dita e marrjes në dorëzim të tyre.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”,* si edhe të pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”.* Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë, të garantojnë Autoritetin Kontraktor, se secili prej mjeteve të ofruara, do të ketë garanci teknike minimumi 1 vit nga dita e marrjes në dorëzim të tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës të deklarojë se, mjetet objekt i procedurës së prokurimit, do të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime materiale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushe të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si edhe të pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Kjo deklaratë, shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor, që mallrat objekt prokurimi, të cilët do të dorëzohen pranë AK, do të shoqërohen me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar, standardeve kombëtare e ndërkombëtare, në funksion të qarkullimit të tyre, konform Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI III-TË: “BLERJE MJETE NIVELIMI (NJË RRUL DHE NJË GREJDER)”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kritereve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kritereve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 dhe nenin 42 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/c citohet: 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak

se 20% e vlerës së së përlllogaritur të kontratës ose lotit që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit ose lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm, që garantojnë Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”,* si edhe të pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”.* Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mjetet e ofruara, janë në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për çdo mjet, si edhe me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë garancie për mjetet e ofruara, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi gjatë periudhës së garancisë, si dhe periudha e garancisë teknike për secilin mjet, do të jetë minimumi 1 vit nga dita e marrjes në dorëzim të tyre.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”,* si edhe të pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”.* Vendosja e këtij kriteri, i

shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të garantojnë Autoritetin Kontraktor, se secili prej mjeteve të ofruara, do të ketë garanci teknike minimumi 1 vit nga dita e marrjes në dorëzim të tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës të deklarohet se, mjetet objekt i procedurës së prokurimit, do të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushe të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”,* si edhe të pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”.* Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Kjo deklaratë, shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor, që mallrat objekt prokurimi, të cilët do të dorëzohen pranë AK, do të shoqërohen me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar, standardeve kombëtare e ndërkombëtare, në funksion të qarkullimit të tyre, konform Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI I-RË: “BLERJE MJETE TRANSPORTI (DY KAMIONA, TRE KAMIONÇINA DHE NJË KAMION ME VINÇ)”

1- Kamion 4 aksial 20 m³ vetëshkarkues duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

• Viti i prodhimit:	Jo më herët se viti 2020
• Kilometra të përshkuara:	I ri (me 0 km)
• Fuqia e motorrit:	Minimumi 440 hp
• Lënda djegëse:	Naftë
• Akse:	8x4
• Sistemi i frenimit:	ABS
• Trasmisioni:	Manuale
• Cilindra:	6
• Karrocëria:	Vetëshkarkuese
• Gjatësi totale e mjetit:	Minimumi 6 m
• Gjerësi totale e mjetit:	Minimumi 2.3m
• Numri i vendeve:	Minimumi 2
• Standarti i emetimit:	Euro 6
• Peshëmbajtja totale:	Minimumi 40000 kg
• Volumi:	20 m ³
• Pozicionimi i timonit:	Krahu i majtë

2- Kamioçinë vetëshkarkuese dopjo gabinë 3.5 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

• Viti i prodhimit:	Jo më herët se viti 2010
• Fuqia motorike:	Minimumi 135 hp
• Kilometrazhi:	Jo më shumë se 200,000 km
• Lënda djegëse:	Naftë
• Trasmisioni:	Manuale

• Numri i marsheve:	6
• Standarti i emetimit:	Minimumi Euro 4
• Gjatësia totale e mjetit:	Minimumi 5.5 m
• Gjerësia totale e mjetit:	Minimumi 2 m
• Numri i pasagjerëve:	Minimumi 6
• Pesha maksimale me ngarkesë të plotë teknikisht e lejueshme:	3500 kg
• KarrocERIA:	Vetëshkarkues
• Aksi pasëm:	Dopjo gomë
• Sistemi i drejtimit:	Krahu i majtë
• Timoni:	Hidraulik
• Sponde:	Me hapje

3- Kamioçinë vetëshkarkuese tek gabinë 3.5 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

• Viti i prodhimit:	Jo më herët se viti 2010
• Kilometrazhi:	Jo më shumë se 200,000 km
• Lënda djegëse:	Naftë
• Fuqia motorrike:	Minimumi 135 hp
• Trasmisioni:	Manuale
• Numri i marsheve:	6
• Standarti i emetimit:	Minimumi Euro 4
• KarrocERIA:	Vetëshkarkuese
• Gjatësia totale e mjetit:	Minimumi 5.5 m
• Gjerësia totale e mjetit:	Minimumi 2 m
• Numri i pasagjerëve:	Min 2
• Masa maksimale me ngarkesë të plotë teknikisht e lejueshme:	3500 kg
• Aksi pasëm:	Dopjo gomë
• Sistemi i drejtimit:	Krahu i majtë
• Timoni:	Hidraulik

• Sponde: Me hapje

4- Kamion 2-3 aksial vetëshkarkues me vinç + 4 ton duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2004
- Kilometra të përshkuara: Jo më shumë se 250 000 Km
- Fuqia: Jo më pak se 220 Kw
- Lënda djegëse: Naftë
- Numri i akseve: (2-3), 4x4
- Gomat e aksit mbrapa: Dopjo gomë
- Kabina: E shkurtër
- Trasmisioni: Manuale
- KarrocERIA: Vetëshkarkuese
- Gjatësia totale e mjetit: Minimumi 8.5
- Gjërësia totale e mjetit: Minimumi 2.4
- Numri i vendeve: Minimumi 2
- Kapaciteti i kazanit: Minimumi 6 m³
- Standarti i emetimit: Minimumi euro 4

Vinçi:

- Gjatësia e hapjes: Minimumi 10 m,
- Numri i hapjeve: Minimumi 3
- Pesha mbartëse: Minimum 4 ton në bigën e parë dhe minimumi 600 kg në hapjen e plotë.

-Mjetet objekt i procedurës së prokurimit, të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushe të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Mjetet duhet të jene të mbuluar me nje garanci teknike minimumi **1 vit**, nga dita e marrjes ne dorezim te tyre. Kjo garanci teknike eshte kerkuar, per arsye se, gjate puneve te ndryshme qe mjetet do te zhvillojne gjate ketij afati kohor prej minimumi 1 vit, eshte gjykuar si e arsyeshme qe eshte koha e mjaftueshme per testimin teknik te mjeteve.

-Mjetet duhet të dorezohen me të gjitha shërbimet teknike të kryera (vaj, filtra, etj.)

Vendi i ekzekutimit të kontratës: Në magazinën e Bashkisë Divjakë.

Shënim: Mjetet e përdorura (me kilometrazh/ore pune më shumë se 0):

Mjetet duhet të jenë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, goditjet etj. Tubat e presionit të vajit, të jenë në gjendje të mirë (të pa gripuara). Gomat të jenë në gjendje të mirë (jo të konsumuara).

Mjetet e përdorura objekt i procedurës së prokurimit do të pranohen (do të merren në dorëzim përfundimtar pas kolaudimit), nga një komision i posaçëm i ngritur nga autoriteti kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Afati i kolaudimit do të jetë (prova, testim në terren) jo më shumë se 7 ditë kalendrike ose 5 ditë pune.

Afati i lëvrimit: Për Loti I-rë: “Blerje mjete transporti (dy kamiona, tre kamionçina dhe një kamion me vinç)” është 2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Kamion 4 aksial 20 m ³ vetëshkarkues	2	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
2	Kamionçinë vetëshkarkuese dopjo gabine 3.5 ton	2	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
3	Kamionçinë vetëshkarkuese tek gabine 3.5 ton	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
4	Kamion 2-3 aksial vetëshkarkues me vinç + 4 ton	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës

⇒ **Argumentimi i specifikimeve teknike të mjeteve perkatesisht si me poshte:**

1) Konkretisht për mjetin Kamion 4 aksial 20 m³ vetëshkarkues, grupi i punës i caktuar me urdher për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton të specifikimet teknike se:

Pika 1-2-13- Është përcaktuar që mallrat objekt prokurimi të jenë të reja, të papërdorura, ku viti i prodhimit të jetë jo më parë se 2020 (që në fakt bëhet fjalë për një periudhë të arsyeshme që përfshin 5 (pese) vite prodhimi 2020, 2021, 2022, 2023, 2024). Kjo është kërkuar që mjetet e kërkuara, të jenë të prodhimit të viteve të fundit, në mbështetje edhe të pikës 8/b të V.K.M nr.633 datë 16.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike” në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe direktivave të BE për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, në varësi të kategorizimit të mjeteve, sipas peshës dhe kohës së përdorimit. Këto mjete bëjnë pjesë në gjeneratën e re në drejtim të ekonomisë së karburantit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë teknike, efikasitetit dhe efikasitetit në koston e përgjithshme, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit si edhe në rregullimin dhe emëtimin e gazrave në natyrë.

Pika 3-5- Kerkohet minimumi fuqia 440 hp per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per ngarkesen e kerkuar, dhe akse 8x4 per nje qendrueshmeri te larte te mjetit nje ballancim uniform te ngarkeses ne terrene te veshtira.

Pika 4- Për këtë procedure për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzin është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse për këtë procedure është zgjedhur lënda djegëse “Naftë” është dhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se janë mjete të rënda dhe janë të presupozuara të punojnë në terrene të veshtira dhe kerkojnë një force motorrike të konsiderueshme është përzgjedhur lënda djegëse “Naftë” dhe për arsye te fuqisë kalorifike qe ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke testuar edhe tregun përgjithësisht për mjetet e rënda lënda djegëse është “Naftë”. Motorri me naftë është më i thjeshtë, ka më shumë qëndrueshmeri dhe jetëgjatësi më të lartë.

Pika 6- Sistemi ABS- Anti-lock Brake System ose në shqip sistemi që nuk e lejon gomën të bllokohet plotësisht. ABS na ndihmon në situatën e një frenimi të fortë ku në rastin e një makine pa abs goma do bllokohej 100% nga freni dhe mundësia për të manovruar me ane te timonit humbet totalisht duke qënë se goma nuk ka më aftësinë rrotulluese për të bërë të mundur drejtimin. Në rastin kur mjeti është i pajisur me sistemin ABS gjatë një frenimi të forte ABS nuk na lejon që goma të bllokohet kjo i jep shoferit mundësinë që dhe të frenojë në maksimum por dhe të shmanget duke perdorur timonin.

Pika 7- Transmesioni manual është në mjetet e rëndë ku këto transmesione kanë një përdorim të shumicës për shkak të efikasitetit të tyre të fillimit për të ngarkuar ose tërhequr një peshë me një shpejtësi të caktuar, të shoqëruara nga mbështetëse të tilla si një motor elektrik së bashku me një të ashtuquajtur konvertues **çift** rrotullues të dyfishtë, si dhe një motor frenues që mund të parandalojë dëmtimin e transmetimit në ndalesa të papritura. Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojne me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 8- Motorri me 6 cilindrata prodhon me shume fuqi/moment. Motorri ka punim te qete me pak zhurma ne kabine edhe eficence ne konsum.

Pika 9- KarrocERIA duhet vetshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 10-11- Permasat e mjetit i referohen plotesimit te kapacitetit mbajtes.

Pika 12- Minimumi 2 vende per arsye se duhet te kete edhe nje vend per nje ndihmes(shofer/punetor).

Pika 14-15- Minimumi i peshes 40,000 kg eshte vendosur per arsye te transportimit te kategorive te ndryshme te inerteve, per nje volum prej 20m³.

Pika 16- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

2) Per mjetin Kamioncine vetshkarkuese dopjo gabine 3.5 ton, grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kerkohet minimumi fuqia 135 hp per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar.

Pika 3- Kilometrazhi jo me shume se 200,000 km per arsye se mjete nuk eshte konsumuar, amortizuar shume.

Pika 4- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lëndë djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Gjithashtu duke iu referuar edhe testimit të tregut, përgjithësisht për këto mjete lëndë djegëse është “Naftë”.

Pika 5- Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojnë me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 6- Numri i marsheve 6 per arsye se efienca e mjetit motorrik eshte me e larte dhe konsumi eshte me i vogel.

Pika 7- Euro 4 per arsye te reduktimit te emetimit te gazrave ne natyre.

Pika 8-9- Gjatesia jo me e vogel se 5.5 m dhe gjersia jo me e vogel se 2 m per arsye te lehtesirave te trasportimit te mallrave dhe mundesi shfrytezimi me shume te mjetit.

Pika 10- Per arsye te trasportimit me te lehte dhe te shpejt te punonjesve ne vendin e punes.

Pika 11- Peshë 3500kg per arsye te lehtesirave te perdorimit te mjetit pasi mund te drejtohet me patent te klasit B.

Pika 12- Karrocera duhet vetshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 13- Dopolio gome per qendrushmeri me te larte te mjetit ne terrene te veshtira dhe lehtesi ne mbajtje te ngarkeses.

Pika 14- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

Pika 15- Per manovrueshmeri me te lehte te sistemit te drejtimit.

Pika 16- Per lehtesi dhe efikasitet ne pune.

3) Per mjetin Kamioncine vetshkarkuese tek gabine 3.5 ton grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kilometrazhi jo me shume se 200,000 km per arsye se mjete nuk eshte konsumuar, amortizuar shume.

Pika 3- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lëndë djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Gjithashtu duke iu referuar edhe testimit të tregut, përgjithësisht për këto mjete lëndë djegëse është “Naftë”.

Pika 4- Kerkohet minimumi fuqia 135 hp per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar.

Pika 5- Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojne me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 6- Numri i marsheve 6 per arsye se eficenca e mjetit motorrik eshte me e larte dhe konsumi eshte me i vogel.

Pika 7- Euro 4 per arsye te reduktimit te emetimit te gazrave ne natyre.

Pika 8- KarrocERIA duhet veteshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 9-10- Gjatesia jo me e vogel se 5.5 m dhe gjersia jo me e vogel se 2 m per arsye te lehtesirave te trasportimit te mallrave dhe mundesi shfrytezimi me shume te mjetit.

Pika 11- Minimumi 2 vende per arsye se duhet te kete edhe nje vend per nje ndihmes (shofer/punetor).

Pika 12- Pesha 3500kg per arsye te lehtesirave te perdorimit te mjetit pasi mund te drejtohet me patent te klasit B.

Pika 13- Dopolio gome per qendrushmeri me te larte te mjetit ne terrene te veshtira dhe lehtesi ne mbajtje te ngarkeses.

Pika 14- Pozicionimi i timonit duhet te jete i majte per tu pershtatur legjislacionit rrugor Shqiptar.

Pika 15- Per manovrueshmeri me te lehte te sistemit te drejtimit.

Pika 16- Per lehtesi dhe efikasitet ne pune.

4) Per mjetin Kamion 2-3 aksial veteshkarkues me vinc +4 ton grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kilometrazhi jo me shume se 250.000 km per arsye se mjeti nuk eshte konsumuar, amartizuar shume.

Pika 3- Kerkohet minimumi fuqia 220 kw per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar

Pika 4- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lëndë djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse është zgjedhur karburanti “Naftë” është edhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se është mjet i rëndë dhe është i presupozuar të punojë në terrene të vështira dhe kërkon një forcë motorrike të konsiderueshme, është përzgjedhur lëndja djegëse “Naftë” dhe për arsye të fuqisë kalorifike që ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke iu referuar edhe testimit të tregut, përgjithësisht për mjetet e rënda lëndë djegëse është “Naftë”.

Pika 5- Numri i akseve (2-3) dhe mjeti (4x4) aktive per perdorimin e mjetit ne terrene te veshtira.

Pika 6- Dopolio gome per qendrueshmeri me te larte te mjetit ne terrene te veshtira dhe lehtesi ne mbajtje te ngarkeses.

Pika 7- Arsye manovrimi me e lehte e mjetit,

Pika 8- Transmesioni manual i garanton shoferit kontrollin e plotë mbi marshin kur do të beje ndërrimet. Mjetet me transmesioni manual kushtojne me pak, edhe kane kosto me te ulet mirembajtje ne krahasim me mjetet me transmesion automatik.

Pika 9- KarrocERIA duhet veteshkarkuese per te lehtesuar punen dhe kursim kohe.

Pika 10-11- Gjatesia jo me e vogel se 8.5 m dhe gjersia jo me e vogel se 2.4 m per arsye te lehtesirave te transportimit te mallrave dhe mundesi shfrytezimi me shume te mjetit.

Pika 12- Minimumi 2 vende per arsye se duhet te kete edhe nje vend per nje ndihmes(shofer/punetor)

Pika 13- Permasat e mjetit i referohen plotesimit te kapacitetit mbajtes.

Pika 14- Euro 4 per arsye te reduktimit te emetimit te gazrave ne natyre.

Pika 15-16- Materialet e transportuara te lihen ne destinacionin perkates edhe aty ku mjeti nuk arrin.

Pika 17- Mundesia me e madhe e transportimit te materialeve te ndryshme ne peshe.

Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

LOTI III-TË: “BLERJE MJETE NIVELIMI (NJË RRUL DHE NJË GREJDER)”

1. Rul 8 ton, për ngjeshjen e rrugëve të parcelave duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- | | |
|------------------------|--------------------------|
| • Viti i prodhimit: | Jo më herët se viti 2000 |
| • Orë pune: | Maksimumi 10.000 orë |
| • Pesha e punës: | Minimumi 8000 (kg) |
| • Diametri rullit: | Minimumi 1200 mm |
| • Lënda djegëse: | Naftë |
| • Fuqia: | Minimumi 68 kw |
| • Sistemi i drejtimit: | Hidraulik |
| • Rrota vibruese: | Përpara |
| • Konfigurimi: | Hekur/Gomë |
| • Sistemi i frenimit: | Hidrostatik |
| • Kabina: | Kundër vibrimit |
| • Drita pune: | Para/Mbrapa |

- Buton STOP për emergjenca
- Alarm për ecje mbrapa

2. Greider për nivelimin e rrugëve të parcelave duhet të jetë me parametrat si më poshtë:

- Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 1990
- Fuqia: Minimumi 100 kw
- Lënda djegëse: Naftë
- Orë pune: Maksimumi 13.000 ore
- Pesha e operimit: Minimumi 14000 (kg)
- Thika qendrore: Minimumi 3600mm
- Gjatësia e mjetit: Minimumi 9m
- Gjerësia e mjetit: Minimumi 2.5m
- Konfigurimi: 6x4
- Drita pune: Para/Mbrapa

-Mjetet objekt i procedurës së prokurimit, të jenë të pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e secilit prej mjeteve objekt i kësaj procedure prokurimi, duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj (sipas rastit), si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tyre, siç përcaktohen në Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor

-Mjetet duhet të jene te mbuluar me nje garanci teknike minimumi **1 vit**, nga dita e marrjes ne dorezim te tyre. Kjo garanci teknike eshte kerkuar, per arsye se, gjate puneve te ndryshme qe mjetet do te zhvillojne gjate ketij afati kohor prej minimumi 1 vit, eshte gjykuar si e arsyeshme qe eshte koha e mjaftueshme per testimin teknik te mjeteve.

-Mjetet duhet te dorezohen me te gjitha sherbimet teknike te kryera (vaj, filtra, etj.)

Vendi i ekzekutimit të kontratës: Në magazinën e Bashkisë Divjakë.

Shënim: Mjetet e përdorura (me kilometrazh/ore pune më shumë se 0):

Mjetet duhet të jenë në gjendje shumë të mirë motorike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, goditjet etj. Tubat e presionit te vajit, te jene ne gjendje te mire (te pa gripuara). Gomat te jene ne gjendje te mire (jo te konsumuara).

Mjetet e perdorura objekt i procedures se prokurimit do të pranohen (do te merren në dorëzim përfundimtar pas kolaudimit), nga nje komision i posacem i ngritur nga autoriteti kontraktor, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

-Afati i kolaudimit do te jete (prova, testime ne terren) jo me shume se 7 dite kalendarike ose 5 dite pune.

Afati i levrimit: Për Loti III-të: “Blerje mjete nivelimi (një rrul dhe një grejder)” është 2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Rul 8 ton, për ngjeshjen e rrugëve të parcelave	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës
2	Grejder për nivelimin e rrugëve të parcelave	1	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	2 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës

⇒ **Argumentimi i specifikimeve teknike te mjeteve perkatesisht si me poshte:**

1) Konkretisht per mjetin Rul 8 ton per ngjeshjen e rrugve te parcelave, grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Per arsye te amortizimit te mjetit, gjendja e tij.

Pika 3- Per arsye te funksionit qe mjeti do zhvilloj ne terren.

Pika 4- Per nje manovrim me efikas te mjetit.

Pika 5- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lënda djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse është zgjedhur karburanti “Naftë” është edhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se është mjet i rëndë dhe është i presupozuar të punojë në terrene të vështira dhe kërkon një forcë motorrike të konsiderueshme, është përzgjedhur lëndja djegëse “Naftë” dhe për arsye të fuqisë kalorifike që ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke iu referuar edhe testimit të tregut, përgjithësisht për mjetet e rënda lënda djegëse është “Naftë”.

Pika 6- Pershtatje me nevojat e punes.

Pika 7- Per manovrueshmeri me te lehte te sistemit te drejtimit.

Pika 8- Per eficenc me te larte te ngjeshjes.

Pika 9- Manovrueshmeri me te larte, konfigurimi hekur-gome.

Pika 10- Efikasiteti me i larte dhe siguri.

Pika 11- Per sigurine dhe komoditetin e monovratorit.

Pika 12- Dritat e punes para-mbrapa jane te domosdoshme per punen gjate nates, per sinjalistik dhe siguri ne pune.

Pika 13- Per arsye sigurie dhe avarie te mjetit.

Pika 14- Alarmi per ecje mbapa duhet per kujdesin dhe sigurine e punonjesve.

2) Konkretisht per mjetin Greider per nivelimin e rrugeve te parcelave, grupi i punes i caktuar me urdher per hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike argumenton te specifikimet teknike se:

Pika 1- Per percaktimin e vitit te prodhimit u bazua te buxheti dhe ne studimit te tregut.

Pika 2- Kerkohet minimumi fuqia 100 kw per arsyen se mjetet ne kete fuqi kane rendiment me te larte per punen e kerkuar.

Pika 3- Për këtë procedurë, për llojin e karburantit është zgjedhur lëndë djegëse “Naftë”, për shkak se dallimi kryesor në mes të motorëve me naftë dhe me benzinë është efikasiteti termik që motorët me naftë kanë. Motorri me naftë është 20% më efikas sesa motorrat me benzinë, gjë që ndikon drejtë për drejtë me rritjen e ekonomisë së karburantit në 20%. Arsye tjetër se përse është zgjedhur karburanti “Naftë” është edhe tipologjia e mjetit. Duke qënë se është mjet i rëndë dhe është i presupozuar të punojë në terrene të vështira dhe kërkon një forcë motorrike të konsiderueshme, është përzgjedhur lëndja djegëse “Naftë” dhe për arsye të fuqisë kalorifike që ajo ka (më të lartë se benzina). Gjithashtu duke iu referuar edhe testimit të tregut, përgjithësisht për mjetet e rënda lëndë djegëse është “Naftë”.

Pika 4- Nje amortizim te mjetit te pranueshem, gjendja e tij teknike brenda normave.

Pika 5- Ploteson funksionet qe mjete do zhvilloj ne terren, per sistemimin e rrugeve te parcelave.

Pika 6- Per nje efikasitet sa me te mire te mjetit ne terren.

Pika 7-8- Duke u pershtatur formatit te punen qe mjete do te kryeje ne terren, jane permasat me te volitshme. Efikasiteti dhe manovrueshmeria e mjetit ne pune jane me te larte.

Pika 9- Akse 6x4 per nje qendrueshmeri te larte te mjetit nje ballancim uniform te peshes ne terrene te ndryshme.

Pika 10- Dritat e punes para-mbrapa jane te domosdoshme per punen gjate nates, per sinjalistik dhe siguri ne pune.

Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërish të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi, janë hartuar duke u diktuar nga nevoja gjithmonë e në rritje për mjete të cilat ndihmojnë stafin e AK, në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT